

V E N D I M
Nr.381, datë 20.5.1996

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË 14.12.1994 “PËR STATUSIN E INVALIDIT”

Në zbatim të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në zbatim të neneve 1 dhe 2 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, invalidi për të përfituar shtesën mujore mbi pension, të paraqesë pranë drejtorisë së sigurimeve shoqërore të rrethit përkatës, librezën e pensionit të invaliditetit.

2. Në zbatim të nenit 7 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”:

a) Invalidëve që kanë qenë të punësuar në ndërmarrjet ose institucionet shtetërore dhe ish-kooperativat bujqësore dhe janë me sëmundje profesionale ose të aksidentuar në punë u jepet një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit si përfitim paaftësie në masën:

- 1700 lekë, për invalidët që kanë nevojë për asistencë të vazhdueshme të një personi tjetër.

- 1500 lekë, për invalidët që janë plotësisht të paaftë për punë.

- 1300 lekë, për invalidët që janë pjesërisht të aftë për punë.

b) Paraplegjikët dhe të paralizuarit që përfitojnë pension të plotë pleqërie, marrin përfitim mbi pensionin e invaliditetit në masën 1500 lekë në muaj.

c) Invalidët nga sëmundjet e përgjithshme, që përfitojnë pension dhe që kanë nevojë për shërbim, marrin përfitim paaftësie mbi pensionin e invaliditetit në masën 1500 lekë në muaj.

Shtesat e parashikuara në gërmat a, b dhe c vazhdojnë edhe kur invalidi del në pension pleqërie.

Për periudhën maj 1995 deri më 30 qershor 1996 në planin e shpenzimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, shtohen 71 milionë lekë të cilat përballohen nga fondi buxhetor i parashikuar për punën publike.

Efektet financiare të periudhës korrik-dhjetor 1996 do të financohen nga Këshilli i Ministrave në fund të vitit sipas shpenzimeve faktike.

4. Në zbatim të nenit 8 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, Institutit të Sigurimeve Shoqërore i akordohet çdo vit nga buxheti i shtetit një fond në lekë për blerjen:

a) e mjeteve lëvizëse dhe të pajisjeve të ndryshme ortopedike;

b) e mjeteve ndihmëse dëgjimore e pamore speciale;

c) e mjeteve ndihmëse kardiake etj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga 1.5.1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi